



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:089479

Datë: 24.01.2024

Numri i dokumentit: 05294061

PS.nr. 36/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti Special, në Trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Violeta Namani-Hajra – Kryetare e Trupit Gjykues, gjyqtarët Musa Konxheli dhe Arben Hoti si anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional Albert Haliti, në çështjen penale kundër të pandehurve L. D., K. H. dhe O. H., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nen par.3.1 lidhur me par. 1 e nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.35/23, të datës 04.08.2023, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 04.12.2023, në prezencën e palëve në procedurë gjykata me datë 07.12.2023, mori dhe shpalli publikisht dhe përpiloi me datë **04.01.2024** këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1. L.D., i lindur më datë ..., në P., nga i ati Xh. dhe e ëma A., me vendbanim në fshatin ..., Komuna e F. K., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak nga data 12.04.2023 deri me datë 07.12.2023.

2. K.H., i lindur më datë ..., në P. nga i ati A. dhe e ëma L., me vendbanim në rrugën "... nr.. F. K., ka kryer shkollën fillore, tregtar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak nga data 12.04.2023 deri me datë 07.12.2023.

3. O.H. i lindur më datë ..., në P. nga i ati A. dhe e ëma L., me vendbanim në rrugën "...", nr..., në P., i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak nga data 12.04.2023 deri me datë 07.12.2023.

I. Të pandehurit L.D., K.H. dhe O.H. në bazë të nenit 364 par 1 të KPP-së,

JANË FAJTOR

Sepse është vërtetuar se të pandehurit L.D., K.H. dhe O.H. në bashkëkryerje me datë 11.04.2023, rreth orës 23:00, në P. të motivuar me ideologji ekstreme radikale Islame përkatësisht të besimit fetarë, kanë lënduar lehtë të dëmtuarin V. S., për shkak të një publikimi në profilin e tij në rrjetin social "Facebook" për profetin Muhamed dhe profetin Isa, paraprakisht e përcjellin të dëmtuarin V. S. nga TV "...", dhe me të arritur afër restorantit "...", në lagjen "..." në P., që të tre të pandehurit e lartcekur e sulmojnë fizikisht me grushta në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit të dëmtuarin V.S. duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, për çka edhe si rast urgjent i njëjti dërgohet në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë për ndihmë mjekësore dhe se me punën operative të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës të pandehurit e lartcekur më datë 12.04.2023 arrestohen.

- Me këtë të pandehurit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par.3.1 lidhur me par. 1 e nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata me aplikimin e neneve **7,17, 38, 39,40, 42, 69, 79, 185 par. 3 nën par.3.1 lidhur me par.1 e nenin 31 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së**, të pandehurit i :

GJYKON

Të pandehurit **L.D.**, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 2 (dy) vite**, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe në masën e arrestit shtëpiak prej datës 12.04.2023, e deri me datë 07.12.2023, i cili dënim do te ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Të pandehurit **K.H.** i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 2 (dy) vite**, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe në masën e arrestit shtëpiak prej datës 12.04.2023, e deri me datë 07.12.2023, i cili dënim do te ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Të pandehurit **O.H.**, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 2 (dy) vite**, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe në masën e arrestit shtëpiak prej datës 12.04.2023, e deri me datë 07.12.2023, i cili dënim do te ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Në mbështetje të nenit 366 lidhur me neni 181 par 7 të KPP-së, të pandehurve L.D., K.H. dhe O.H., ju ndërpritet masa e arrestit shtëpiak, pasi që kanë pushuar kushtet ligjore për masën e njëjtë.

Obligohen të pandehurit se cili veç e veç që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari V.S. me adresë të banimit lagjja "...", rruga "..." në P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Arsyetimi

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me datë 04.08.2023, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PPS.nr.35/23, kundër të pandehurve L.D., K.H. dhe O.H., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par.3.1 lidhur me par. 1 e nenin 31 të KPRK-së.

Duke vepruar sipas aktakuzës konform nenit 240 të KPP-së, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.08.2023 pas leximit të aktakuzës të pandehurve L.D., K.H. dhe O.H. i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me veprën penale me të cilën janë ngarkuar. I pandehuri L.D. ka deklaruar se unë nuk du me u gjykua nga gjykata me këto ligje, por vetëm në bazë të ligjeve të Allahut, sa i përket sulmit e kam pranuar prej fillimit në deklaratë të dhënë në stacionin policore dhe në prokurori, e pranoj edhe tash që e kom krye sulmin, nuk e pranoj aktakuzën, i pandehuri K.H. ka deklaruar se i pranoj veprimet, por nuk e pranojnë aktakuzën pasi që nuk pranojnë të gjykoem nga gjykata. Ndërsa, i akuzuari O.H. nuk ka pranuar të flasë, andaj është konsideruar se mbrohet në heshtje.

Tutje, kryetarja e trupit gjykues, i ka udhëzuar të pandehurit L.D., K.H. dhe O.H. në të drejtat e tyre të parapara me nenin 243 dhe 244 të KPP-së, ashtu që të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre janë udhëzuar se kanë të drejtë në afat prej 30 ditëve nga dita e shqyrtimit fillestar të paraqesin kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave. Mbrojtësit e të pandehurve L.D., av. M. Z. S., dhe të pandehurit K.H., av.R. K., në afatin ligjor, kanë parashtruar në gjykatë kërkesë për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave. Konform nenit 245 të KPP-së, gjykata i ka dhënë mundësinë Prokurorisë Speciale, që të përgjigjet në lidhje me kërkesat e ushtruar nga mbrojtësit e të pandehurve, si më lartë. Me datë 22.09.2023, Gjykata ka pranuar përgjigjen nga Prokuroria Speciale, lidhur me kërkesat si më lartë.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesave për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, me Aktvendimin PS.nr.36/23 të datës 03.10.2023 ka refuzuar si të pabazuar këto kërkesa, duke lënë aktakuzën në fuqi. Ndaj këtij vendimi të gjykatës, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë mbrojtësi i të pandehurit O.H., av.Rr. A., e të cilën ankesë Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin PN.S.nr.62/2023, të datës 03.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar.

Shqyrtimi gjyqësor

Gjykata, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 23.11.2023, e ka udhëzuar të pandehurit L.D., K.H. dhe O.H. për të drejtat e tyre ligjore, ku palët heqin dorë për leximin e aktakuzës nga prokurori i Prokurorisë Speciale. I pandehuri L.D. ka deklaruar se nuk du me u gjykua nga gjykata me këto ligje, por vetëm në bazë të ligjeve të Allahut, sa i përket sulmit e kam pranuar prej fillimit, në deklaratë të dhënë në stacionin policore dhe në prokurori, e pranoj edhe tash që e kom krye sulmin, nuk e pranoj aktakuzën, I pandehuri K.H. ka deklaruar se kamë deklarimin e njëjtë si në seancën fillestare, është parim fetar nuk mund të ngrihem në këmbë,

veprimin e pranoj, e kam pranuar edhe në prokurori edhe në polici, mirëpo gjykimin nga gjykata nuk e pranoj sepse ne e aplikojmë vetëm fenë e Islamit. I pandehuri O.H. ka deklaruar se e kamë qëndrimin e njëjtë si në seancën fillestare ku ka deklaruar se nuk pranoj të ngrihem dhe të flas, konstatohet në heshtje, andaj meqë se të pandehurit e lartcekur nuk e kanë pranuar fajësinë për këtë veprë penale, gjykata duke u bazuar në nenin 323 të KPP-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Deklarimi i palëve në fjalën përfundimtare

Prokurori i Prokurorisë Speciale në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, se ngritur ndaj të pandehurve L.D., K.H. dhe O.H., ngase edhe gjatë seancave të këtij shqyrtimi gjyqësor e pa mëdyshje është vërtetuar se të njëjtit me paramendim dhe me dashje, e në motiv me energji radikale islame përkatësisht të besimit fetar, pas postimit nga ana e të dëmtuarit V.S. në rrjetin social facebook me testin e Muhametit dhe profetit Isa, të njëjtit të revoltuar fillimisht janë takuar në mes veti, kanë shkuar tek TV ... për të prit të dëmtuarin V.S. dhe me pastaj e kanë përcjellë me automjet deri te lagjja “...” e që në hyrje te lokalit “...”, që të tre të pandehurit e kane sulmuar të dëmtuarin V.S. për çka edhe i njëjti ka pasur lëndime të lehta trupore në pjesën ballore dhe në kokë dhe si rast urgjent është dërguar në spitalin regjional për trajtim. Po të mos ishte dëshmitari I. M. për ti i ndal sulmuesit unë besoj epilogu i sulmit për të dëmtuarin V.S. do të ishte dinamik, pra këta të pandehur kane pasur mundësi që të heqin dore nga vepra penale por nuk kanë hezituar duke vazhduar në vazhdimësi për veprimet që i ceka si më larët që të sulmojnë të dëmtuarin. Këtë më se miri e tregon shikimi i video incizimit përkatësisht postimin në facebook, thëniet-barcoleten e të dëmtuarin V.S., është shumë indikative që këta persona kanë shfaq edhe interesim për ta shikuar Kodin Penal të Republikës së Kosovës që sa parashihet dënimi për këtë veprë penale. Kjo gjendje faktike me se miri vërtetohet nga provat materiale të propozuara edhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe atë Raport informues i Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë me nr. .ref: 06/1-03/86-2023, datë 12.04.2023 bashkangjitur edhe raporti i shpejtë me përshkrimin e vendit të ngjarjes me nr. 2023 –AD -1261 të datës 11.04.2023, Raporti fillestarë i incidentit i Policisë së Kosovës në Prishtinë me nr. të rastit 2023- AD- 1261 të datës 11.04.2023, Fletëthirrja e Ndhimës së shpejtë mjekësore se bashku me konstatimin e mjekut datë 11.04.2023, Flete lëshimi i mjekut nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Klinika Emergjente në Prishtinë me nr. të protokolit 23393 të datës 11.04.2023, Raport njoftues i Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref; 06/1-03/12-2023 datë 06.06.2023, mbi analizimin e ekzaminimit të pajisjes (aparati telefonik) i sekuestruar nga i pandehuri L.D.. Akt ekspertimi mjeko ligjor në bazë të dokumentacionit të çështjes lëshuar nga Specialisti i Mjekësisë Ligjore- IML në Prishtinë me nr ref: Pr- 75, datë 24.05.2023 për të dëmtuarin V.S.. Unë besoj se ju do të bindeni në motivin e të pandehurve L.D., K.H. dhe O.H., se që të tre këta janë të redikalizuara me ideologji ekstreme islame duke mos e njohur as këtë gjykatë po e njohin vetëm gjykatën e Allahut, ne i kuptojmë bindjet fetare dhe respekt për të gjithë ata që respektojnë fenë e vet por në asnjë mënyrë nuk ka guxuar që të ndodh një sulm i tillë për motive si me lartë, e të nxitjes së urrejtjes të palës së dëmtuar. Andaj propozoj të pandehurit L.D., K.H. dhe O.H. të shpallen fajtor dhe te dënohen sipas kodit penal dhe si rrethana rënduese të konstatohet pesha e veprës penale, këmbë ngulësia për të kryer veprën penale, rrezikshmëria e veprës penale si dhe sjelljet e të pandehurve në

gjykatë por megjithatë nuk mund të anashkalohej edhe si rrethane lehtësuese gjendja familjare e tyre dhe mosha e tyre duke shpresuar se me një dënim adekuat sipas ligjit ku të njëjtëve do t'ju ndikoj pozitivisht edhe kryerësve të mundshëm potencial.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar V.S., av. K. P. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesim në tërësi fjalën e prokurorit në këtë çështje, nga provat e administruara në këtë gjykim vërtetohet pa mëdyshje përtej çdo dyshimi se të pandehurit e kanë kryer veprën penale e cila ju bie në barrë me kohën dhe në mënyrën e përshkruar në aktakuzë. Madje të njëjtën të pandehurit e kanë pranuar në çdo fazë të procedurës, fillimisht duke pretenduar se kanë qenë të provokuar nga i dëmtuari si rezultat i një statusi të tij në rrjetin social facebook, e më pas kanë qenë të provokuar nga ai në natën e sulmit. I dëmtuari V.S. nuk është viktimë e rëndomtë e një krimi të rëndomtë, i njëjti është gazetar dhe ka qenë viktimë i këtij sulmi për faktin se ka qenë gazetar duke qenë se Republika e Kosovës është vend i lirë dhe demokratik, i bazuar në kushtetutë dhe ligje, të cilat garantojnë fjalën e lirë e gjithashtu edhe ushtrimin e besimeve fetare në mënyrë të lirë, kjo në asnjë mënyrë nuk i jep të drejtë asnjë personi që të sulmoj persona të tjetër për shkak të ushtrimit të drejtave kushtetuese dhe ligjore për shkak të ushtrimit të fjalës se lirë. Në fakt të pandehurit kanë pasur mjete juridike në dispozicion në rast se janë ndjerë të ofenduar nga shprehja e fjalës së lirë nga i dëmtuari. Në vend se të njëjtit të ushtrojnë të drejtat e tyre juridike në përputhje me ligjin e Republikës së Kosovës, përkatësisht ligjit civil për shkak të shpifjes dhe fyerjes, të njëjtit kanë zgjedhur dhunën si mjet për të heshtur V.S. dhe për të heshtur të gjithë ata të cilët marrin guximin që të ushtrojnë të drejtën kushtetuese për fjalën e lirë në Republikën e Kosovës. Sulmi ka pasur ndikim jashtëzakonisht të madh jo vetëm tek i dëmtuari V.S. por edhe te familja e tij e ngushtë dhe e gjerë dhe tek shoqëria e tij e po ashtu edhe i gjithë komiteti i gazetarëve në Republikën e Kosovës. Andaj në rastin e shqiptimit të sanksionit penal gjykata duhet të ketë parasysh të gjitha këto rrethana rënduese si dhe faktin se sulmet e tilla ndaj gazetarëve janë fenomen në rritje e sipër. Në përputhje me nenin 459 të KPP-së pala e dëmtuar propozon që me rastin e vendosjes për aktakuzën, të vendoset edhe për kërkesën pasurore juridike për të dëmtuarin, e cila në këtë rast propozon që të jetë në shumen prej 30 mijë Euro, për shkak të pasojave të rënda për të dëmtuarin dhe familjen e tij dhe shqetësime të shkaktuar si rezultat i kryerjes se veprës penale, gjë që vërtetohet edhe nga deklarata e të dëmtuarit V.S. e dhënë në këtë gjykatë.

I dëmtuari V.S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklarimin e mbrojtësit tim, nuk kamë asgjë për të shtuar.

Mbrojtësja e të pandehurit L.D., av.M. B. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga administrimi i provave personale dhe materiale nuk është arritur të provohet përtej çdo dyshimi që i mbrojturi i saj të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Sipas mbrojtjes, i mbrojturi i saj ka shkuar që të takohet me të dëmtuarin dhe të bashkëbisedojnë lidhur me qëndrimin e tij të shprehur në rrjetet sociale në muajin e shenjtë të Ramazanit me të cilën ofendonte Pejgamberin Muhamed dhe Isa. Pra, i mbrojturi i saj vetëm ka dashur që të bisedojë me çka edhe i ka thënë: “mfal a bon veç pak qetu”, por që i dëmtuari ka ofenduar duke iu thënë: “ çfarë doni ju majmuna”, dhe pastaj siç ka deklaruar edhe vet i dëmtuari, i njëjti ka filluar të vrapojë në drejtim të restorantit ku për shkak që kockat ishin të rrëshqitshme është rrezuar dhe kjo pa arritur që të

pandehurit të kenë kontakt fizik me të. Në këtë mënyrë, të pandehurit duke u ndier të fyer dhe provokuar nga fjala: ‘majmun’, e kanë goditur me shuplak dy herë, ndërsa gjatë kohës sa i dëmtuari tenton të ngrihet nga toka, i njëjti lëndohet nga ora e njërit prej të pandehurve si pasojë e të cilës i rrjedhë gjak. Vepra e tillë penale mund të kryhet vetëm me dashje e që një dashje e tillë nuk ka ekzistuar te i mbrojturi i saj. Veprimet e ndërmarra më së miri do të vërtetoheshin poqe se do të shfaqeshin incizimet e nxjerra nga kamerat e sigurisë në Restorantin ‘...’, ku do të vërtetohej që komunikimi nga të pandehurit ishte miqësor dhe se nuk ka pasur qëllim sulmi ndaj të dëmtuarit dhe se i dëmtuari ishte ai që kishte provokuar në mënyrë të vrazhdë të pandehurit. Nuk qëndron kualifikimi juridik i akuzës lidhur me par.3 pasi që lëndimi i lehtë trupor ka ardhur si pasojë e provokimit (ofendimit), e në asnjë mënyrë për shkak të bindjeve të tij fetare dhe nuk mund të cilësohet i dëmtuari si ‘viktimë e ndjeshme’. Tutje, ka shtuar se me rastin e marrjes së vendimit, do të duhet të merrej parasysh edhe par.4 i nenit 185 ku përcaktohet se nëse kryesi është i provokuar nga sjelljet çnjerëzore apo të vrazhda nga i dëmtuari, atëherë gjykata mund të shqiptojë vërejtje gjyqësore. Prokuroria nuk ka arritur t’i përshkruaj veprimet e secilit prej të pandehurve, e po ashtu nga dëgjimi i dëshmitarit I. M. vërtetohet se i dëmtuari është goditur nga dy persona, e jo nga tre siç pretendon prokuroria. Në rrethana të tilla, dhe duke pas parasysh parimin ‘in dubio pro reo’, i ka propozuar gjykatës që të mbrojturin e saj ta lirojë nga akuza dhe me rastin e matjes së dënimit të marrë parasysh si rrethanë lehtësuese: provokimin nga ana e viktimës, moshën e re të pandehurit, bashkëpunimin vullnetar të pandehurit si dhe pranimin e fajësisë nga i pandehuri për konfrontimin fizik me të dëmtuarin, si dhe faktin që asnjëherë më parë nuk është dënuar, është i martuar, baba i dy fëmijëve të vegjël dhe mbajtës i vetëm i familjes.

I pandehuri L.D. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e mbështetë deklarin e mbrojtëses në fjalën përfundimtare dhe se nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të pandehurit K.H., av. R. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë zhvillimit të seancës së sotme, në lidhje me deklarinet e të mbrojturit tim i njëjti edhe në këtë fazë ka pranuar veprën penale siç e quan ai të sulmit ndërsa gjatë fazës hetimore po ashtu i njëjti ka pranuar veprimet e tij duke kundërshtuar motivin e kryerjes se kësaj vepre penale, andaj unë si mbrojtës në rrethanat të cilat ndodhem duke marrë parasysh edhe mbrojtjen efektive dhe mos bashkëpunimin e të pandehurit me mua si mbrojtjes, konsideroj që gjykata ta ketë parasysh cilësimin juridik të kësaj vepre penale ku në dispozitivin e aktakuzës prokuroria ka konstatuar se të pandehurit të motivuar me ideologji ekstreme radikale islame, përkatësisht e besimit fetar e të njëjtit i vie në barrë vepra penale nga neni 185, par 3, nën par 1.3 lidhur me par 1 të KPRK-së, ku në paragrafin 3. nën par 1.3 askund nuk përmendet elementi i ideologjisë ekstreme radikale për veç që përcaktohet se kur vepra penale kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, ose është e motivuar sipas kombësisë, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, andaj në këtë rrethanë konsideroj që vepra penale nga neni 185, par 1 të KPRK-së edhe vet i mbajturi im e ka pranuar, ndërsa sa i përket par 3 dhe faktit se i njëjti ka qenë i motivuar me ideologji ekstreme radikale islame gjatë gjithë këtij shqyrtimi gjyqësor kjo prokuroria nuk e ka vërtetuar dhe as nuk e ka mbështetur në prova materiale sa i përket të mbrojturit tim. Sa i përket fjalës përfundimtare të përfaqësuesit të dëmtuarit, mbrojtja konstaton se në Kosovë ekziston kushtetuta e Republikës së Kosovës si akti më i lartë juridik e po ashtu në këtë kushtetutë është e vërtet se përcaktohet e drejta e shkrehjes

së lirë mirëpo për gjykatën dhe të pranishmit njoftoi përfaqësuesin e të dëmtuarit se gjykata evropiane për të drejtat e njeriut ka përcaktuar kondita të qarta sa i përket të drejtës për shprehjen e lirë, në këtë rrethanë do të ndërlihem edhe sa i përket qëndrimit të të mbrojturit tim gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, qëndrimi i tij që mos ta pranoj këtë gjykatë, rast se e marrin si të mirëqenë statutet sociale dhe shprehjet e lira ne facebook, lus gjykatën që edhe qëndrimin e të mbrojturit tim ta merr si shprehje të lirë. Prandaj në këto rrethana lus gjykatën që ta ketë parasysh dispozitën e nenit 70 par 3 nen 3.1 të KPRK, sa i përket rrethanave lehtësua të mbrojturit tim duke marrë parasysh se është mbajtës i familjes, nuk ka qenë i dënuar me parë , që nga fillimi i procedurës penale nuk i është shmangur përgjegjësisë, në deklaratimet e tij dhe në rrethanat e tjera lehtësuese, e duke u ndërlihur me këtë propozoj gjykatës që ta ketë parasysh edhe dispozitën e nenit 185 par 4 të KPRK-së të mbrojturit tim ti caktoj një dënim më të butë për shkak të gjitha këtyre rrethanë që janë elaboruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike të propozuara nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar, konsideroj se një kërkesë e tillë është e pa bazuar në prova e pa argumentuar dhe si e tillë nuk mund të qëndroj.

I pandehuri K.H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e mbështetë deklaratimin e mbrojtësit në fjalën përfundimtare dhe se nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi të pandehurit O.H. Av. Rr. A. në fjalën përfundimtare ka deklaruar ne si mbrojtje kemi pasur vështirësi në ofrimin e një mbrojtje efektive për të mbrojturin tim për shkak te mos bashkëpunimit me mua si avokat, i mbrojturi im K.H. edhe në këtë shqyrtim gjyqësor por edhe në fazat e më hershme gjate marrjes ne pyetje në prokurori nuk e ka mohuar sulmin e V.S. mirëpo ka mohuar motivin siç është cekur në aktakuzën e prokurorisë, pasi që ky proces penal që nga fillimi i tij mendoj se është bërë në shkelje të ligjit dhe në padrejtësi të mëdha ndaj palës që mbroj unë dhe të akuzuarve të tjerë. Fillimisht vepra u cilësua si lëndim i lehtë trupor por më pas nuk e di se për çfarë arsye kam dyshime që u ndikua nga media, institucioni dhe u ndërrua cilësimi nga lëndimi i lehtë në nxitje e përparjes dhe mos durimit edhe pse dihet qartësisht se kjo vepër nuk ishte kryer nga i pandehuri, më vonë kjo vepër penale prapë është ri cilësuar në atë që duhet të cilësohej Lëndim i lehtë trupor në përjashtim të gabimit që është bërë duke ju referuar par 3 të nenit 185 të Kodit Penal të Kosovës. Unë nuk pajtohem me qëndrimin e të mbrojturit tim dhe të pandehurve tjerë që deklarojnë se nuk pranoj të gjykohen apo nuk e pranojnë këtë gjykim por gjithashtu nuk pajtohen as me mendimin e palës së dëmtuar i cili në seancën e kaluar tha se edhe shakat në profet është e lejuar me ligjet tona, unë jam përkrahës të drejtës së shprehjes, së mendimit mirëpo po shakaja në profet mendoj se nxit urrejtje midis grupeve fetare që jetojnë në Kosovë, prandaj pala e dëmtuar për mendimin tim ka konsumuar veprën penale të nxitjes së përçarjes dhe mos durimit, andaj i kërkoj kësaj gjykate që qëndrimin e të pandehurve lidhur me mos pranimin e gjykimit, të mos e marrë si rrethanë rënduese me rastin e shqyrtimit të vendimit, në rast se i shqiptohet ndonjë dënim gjykatës i propozoj që si rrethanë lehtësuese ta merr faktin se i mbrojturi im ka qenë i sinqertë që nga fillimi, asnjëherë nuk është përpjekur ti ik procedurës penale, është person i moshës së re, prandaj propozoj që të gjitha këto rrethana të merren parasysh dhe gjithashtu të ketë parasysh edhe par 4 i nenit 185 të Kodit Penal të Kosovës.

I pandehuri O.H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e mbështetë deklaratimin e mbrojtësit në fjalën përfundimtare dhe se nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtja e të pandehurve

Të pandehurit L.D., K.H. dhe O.H., në mbrojtjen e tyre gjatë shqyrtimit gjyqësore të datës 04.12.2023 kanë deklaruar se e shfrytëzojnë të drejtën e tyre ligjore që të mbrohen në heshtje.

Deklaratat e të pandehurve L.D., K.H. dhe O.H., e dhëna në procedurë paraprake me pajtimin e palëve në procedurë janë lexuara në cilësi të provës materiale në pajtim me nenin 256 lidhur me nenin 257 par.2 të KPP-së.

I pandehuri L.D., në deklaratën e dhënë në policinë e Kosovës, me datë 12.04.2023, ka deklaruar se me datë 11.04.2023 rreth orës 21:30, i ka thirr dhe i ka ftuar për takim shokët e tij O. dhe K. në F. K., ku edhe janë takuar dhe ka dhënë si ide që të takohen me V.S. lidhur me postimin e tij në rrjete sociale duke u tallur me profetin Muhammed dhe Isa. E ka parë se V.S. është në emision në ... dhe u ka thënë shokëve që të shkojnë atje, por të njëjtit kanë thënë që ndoshta do ishte me mirë ndonjë ditë tjetër, por për shkak të insistimit të tij, janë pajtuar, kanë hipur në veturën e tij të tipit “BMW”, ngjyrë e zezë me targa ... dhe kanë shkuar te ..., ku kanë pritur derisa ka dalur V. dhe për shkak të një tollovie që u krijua aty, nuk kanë mundur që të bisedojnë me V., prandaj e kanë përcjellë të njëjtin deri kur ka zbritur në “...”, ku pastaj kanë zbritur dhe e ka thirr V. shumë qetë dhe pa asnjë presion: “ *O V. nalu të bisedojmë*”, ku V. është kthyer dhe e ka ofenduar duke i thënë: “ *qe ky qeni dhe duke e shajtur me nënë*”, dhe ka vazhduar me vrapuar drejtë një kafiterie, të cilin e ka ndjekur pas dhe para hyrjes së kafiterisë e ka goditur me grushtin në shpinë ose krahë, ndërsa nuk i ka parë veprimet/reagimet e K. dhe O. sepse ka qenë kohë shumë e shkurtër dhe e shpejtë. Në momentin që e ka goditur V. dhe është ngritur për tu larguar, një person që ka qenë me V. e ka kapur për krahu, por që e ka tërhequr krahun nga dora e tij dhe është larguar në drejtim të veturës, ku kanë hipur në veturë, por meqë rruga nuk kishte dalje është detyruar të kthehet mbrapa(rikferc) e që aty kanë qenë rreth 10 persona të cilët ia kanë goditur pasqyrën e anës së majtë me shkelm, e pastaj edhe me gajbe të birrave kanë goditur veturën dhe xhamin e shoferit disa here, duke sharë e fyer vazhdimisht dhe duke tentuar ti hapin dyert e veturës. Pas disa sekondave është liruar rruga dhe kanë dal nga aty. Ka deklaruar se nuk ka qenë i planifikuar sulmi, por vetëm të bisedojnë me V., por pasi janë takuar ka eskaluar situata, ndërsa për orën e gjetur në vendin e ngjarjes ka deklaruar se nuk e dinë e kujt është. Ndërsa deklarata e të pandehurit L.D., të dhëna në PSRK me datë 24.07.2023, në të cilën ka deklaruar se nuk e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë Nxitja e përçarjes apo mos durimit. Ka deklaruar se në mbrëmjen kritike pas iftarit është takuar me K. dhe O. për të pirë kafe, ku pastaj kanë vendosur bashkërisht që të shkojnë n’... për të biseduar me V.S. lidhur me postimet e tij fyese ndaj pejgamberit Muhammed dhe Isa, pasi që e kanë parë se është drejtpërdrejt në emision, kur kanë shkuar tek ... nuk kanë mundur ta takojnë V. sepse i njëjti ka hyrë në veturë menjëherë te një person tjetër, andaj e kanë përcjellë deri kur ka zbritur në “...” tek kafiteria “...”, aty ka dalur V. nga vetura, kanë dalur edhe këta dhe i njëjti e ka thirrur V.: “ *a mundesh me u ndal me bisedua veç pak*”, ku V. i është kthyer me fjalët “ *Çka po don ky far majmuni dhe e ka sharë me nënë*”, ku edhe ka eskaluar situata dhe e ka goditur me grushte në shpinë dhe gjatë ikjes i njëjti është rrezuar në shkallët e lokalit. Pastaj, pasi që e kanë ndërprerë sulmin kanë dalur disa persona nga kafiteria të cilët persona i kanë sulmuar me gurë dhe gajbe të birrave pasi që kanë hyrë në veturë të cilët persona ia kanë sulmuar veturën dhe ia kanë bllokuar rrugën. Pas incidentit kanë shkuar

në drejtim të O. përmes magjistrales P. – M., ku i ka lënë shokët në F. K., ndërsa veturën e ka lënë në lagjen ... në autosallonin” ...”, pronë e përbashkët e babait të tij dhe djalit të axhës K. D.. Motivi i sulmit ka deklaruar se ka qenë për shkak se është ofenduar për fjalët që ia ka thënë V., ndërsa ka shkuar të bisedojë me V. për shkak të postimeve të tij, ka shtuar se nuk e mohon faktin që V. e kanë sulmuar që të tretë, por se deklarohet vetëm për veprimet e tij, për të cilat veprime ka shprehur keqardhje.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit L.D., nga e njëjta vërtetohet se në natën kritike i ka thirr shokët e tij O. dhe K. në F. K., ju ka dhënë si ide që të takohen me V.S. lidhur me postimin e tij në rrjete sociale duke u tallur me profetin Muhammed dhe Isa, më pas kanë hipur në veturën e tij të tipit “BMW”, dhe kanë shkuar te televizioni ..., ku kanë pritur derisa ka dalur V. dhe për shkak të një tollovi që u kriju aty, nuk kanë mundur që të bisedojnë me V., prandaj e kanë përcjellë të njëjtin deri kur ka zbritur në “...”, ku pastaj kanë zbritur dhe e ka thirr V. shumë qetë dhe pa asnjë presion: “ *O V. nalu të bisedojmë*”, ku V. është kthyer dhe e ka ofenduar duke i thënë: “ *qe ky qeni dhe duke e shajtur me nënë*”, dhe ka vazhduar me vrapuar drejtë një kafiterie, të cilin e ka ndjekur pas dhe para hyrjes së kafiterisë e ka goditur me grushtin në shpinë ose krahë, gjykata gjen se në pjesë e deklaratës së tij që deklaroi se “ e ka thirr V. shumë qetë dhe pa asnjë presion: “ *O V. nalu të bisedojmë*”, ku V. është kthyer dhe e ka ofenduar duke i thënë: “ *qe ky qeni dhe duke e shajtur me nënë*”, gjykata gjen se mbrojtja e tij në këtë pjesë të deklaratës nuk gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurve K. dhe O.H., pasi që të njëjtit në mbrojtjen e tyre nuk kanë deklaruar se i dëmtuari V.S. i ka ofenduar me ndonjë fjalë, andaj deklarimi i të pandehurit L.D. se motivi i sulmit ka qenë për shkak se është ofenduar për fjalët që ia ka thënë V., është i pa bazuar, andaj gjykata gjen se pjesët tjera të deklaratës mbrojtja e tij është reale dhe objektive, i pohon të gjitha veprime inkriminuese si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të njëjta veprim i ka pranuar në seancën fillestare dhe në seancën e shqyrtimi gjyqësor tek pjesa e deklarimi rreth aktakuzës lidhur me pranimin ose mos pranimin e fajësisë, si dhe mbrojtja e tij gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarëve V.S. dhe I. M. të ndërgjuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale.

I pandehuri K.H. në deklaratën e dhënë në policinë e Kosovës, me datë 12.04.2023, në të cilën ka deklaruar se me datë 11.04.2023 pas orës 20:00 e ka parë se V.S. është në debat në ..., ku një ditë më herët, i njëjti gazetar kishte bërë nxitje të urrejtjes fetare duke e fyer pejgamberin, për çka është ndier shumë i mllëfosur dhe ka dalur nga banesa ku është takuar rastësisht me vëllain e tij O. dhe shokun L., me të cilët ka biseduar për postimet e V. dhe pastaj janë nisur për të shkuar tek televizioni ..., me veturën “BMW” ngjyrë të zezë, kanë pritur rreth 30 minuta derisa ka dalur V.S., të cilin pastaj e kanë përcjellë deri në vendin ku ka zbritur në “...”, ku pastaj ka dal nga vetura dhe e ka sulmuar vetëm me grushte dhe pastaj kanë ikur, kur e ka sulmuar V.S. nuk i kujtohet se çfarë kanë bërë dy personat tjerë dhe nuk e dinë nëse edhe ata kanë marrë pjesë në sulm. Duke ikur janë sulmuar nga persona të tjerë që i kanë dalë në ndihmë V.S. me gurë dhe gjësende të tjera, duke i dëmtuar edhe veturën. Ndërsa në deklaratën e të pandehurit K.H. të dhëna në PSRK me datë 24.07.2023, në të cilën ka deklaruar se nuk e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë Nxitja e përçarjes apo mos durimit, ka qëndruar pranë deklaratës në polici, përveç pjesës ku është thënë kinse ka bërë urrejtje fetare ndaj gazetarit V.S., më pas ka shtuar se në mbrëmjen e datës 11.04.2023 ka deklaruar se e kanë thirr O. dhe L. për të dal për kafe dhe gjatë

rrugës ka ra për diskutim çështja e V.S. lidhur me postimet e tij në rrjetet sociale me përmbajtje fyese ndaj profetit Muhammed dhe Isa dhe kanë vendosur që të shkojnë për të biseduar me V. dhe për t'ia tërhequr vërejtjen që të mos bëjë postime të tilla duke qenë se është edhe muaji i Ramazanit dhe mundësisht t'i fshijë ato postime. Kanë shkuar te televizion ... për të biseduar me të, por që nuk kanë mundur, andaj e kanë ndjekur me veturë deri kur ka zbritur te kafiteria "...", e aty kanë dal nga vetura dhe L. e ka thirr V. dhe i ka thënë: "Ndalur për të biseduar", por ai nuk është ndalur dhe aty ka eskaluar situata ku edhe kanë shkuar në drejtim të tij dhe ka ndodhur përleshja, ku që të tretë e kanë sulmuar V. me grushte, dhe janë kthyer në veturë, ku pastaj kanë dal nga kafiteria diku rreth 6-7 persona me gurë dhe gajbe duke e goditur automjetin e tyre dhe pastaj janë larguar, ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur, pasi as nxitja, as urrejtja e as dhuna nuk janë të mira.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit K.H., nga e njëjta vërtetohet se në natën kritike e kanë thirr O. dhe L. për të dal për kafe dhe gjatë rrugës ka ra për diskutim çështja e V.S. lidhur me postimet e tij në rrjetet sociale me përmbajtje fyese ndaj profetit Muhammed dhe Isa dhe kanë vendosur që të shkojnë për të biseduar me V. dhe për t'ia tërhequr vërejtjen që të mos bëjë postime të tilla, kanë shkuar te televizion ... për të biseduar me të, por që nuk kanë mundur, andaj e kanë ndjekur me veturë deri kur ka zbritur te kafiteria "...", e aty kanë dalur nga vetura dhe L. e ka thirr V. dhe i ka thënë: "Ndalur për të biseduar", por ai nuk është ndalur dhe aty ka eskaluar situata ku edhe kanë shkuar në drejtim të tij dhe ka ndodhur përleshja, ku që të tretë e kanë sulmuar V. me grushte, gjykata gjen se mbrojtja e tij është reale, e sinqertë dhe objektive, i pohon të gjitha veprime inkriminuese si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të njëjtat veprim i ka pranuar në seancën fillestare dhe në seancën e shqyrtimi gjyqësor tek pjesa e deklarami rreth aktakuzës lidhur me pranimin ose mos pranimin e fajësisë, po ashtu gjykata gjen se sipas të pandehurit të lartcekur deklaron "L. e ka thirr V. dhe i ka thënë: "Ndalur për të biseduar", por ai nuk është ndalur dhe aty ka eskaluar situata", nuk ka deklaruar se i dëmtuari V.S. i ka ofenduar me ndonjë fjalë, si ka deklaruar i pandehuri L.D. më lartë, andaj gjykata gjen se e njëjta mbrojtje gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarëve V.S. dhe I. M. të ndërgjuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale.

I pandehuri O.H. në deklaratën e dhënë në policinë e Kosovës, me datë 12.04.2023, në të cilën ka deklaruar se me datë 11.04.2023, rreth orës 16:00 ka parë në rrjetin social në facebook në profilin e V. S. një batutë për Profetin Muhammed A.S dhe Profetin Isa, e cila batutë kishte të bënte me atë se " *Profeti Muhammed e sheh Jezu Krishtin në parajsë duke vozitur ferrari dhe e ka pyetur pse Isë, unë në deve e ti në Ferrari, Isa ia kthen Maria gruaja e Zotit, unë djali i tij ... ti je veç pejgamber, grahi deve tash*". Po ashtu, ka deklaruar se ka parë edhe një video të V. S. ku shihet personi në fjalë duke u tallë me fenë islame, me të parë këto dy postime si pjesëtarë i besimit islam është ndier tepër i ofenduar dhe i lënduar dhe ka komunikuar me L.D. ku e kanë lënë që të takohen pas iftarit në F. K., afër marketit "...", diku rreth orës 21:00 janë takuar dhe kanë vazhduar tek mobilieria "...", në F. K., ku aty i është bashkuar edhe vëllai i tij K.H., ku edhe kanë biseduar rreth postimeve të publikuara nga gazetari V.S., me të cilat postimet janë të ndier të ofenduar edhe L. dhe K., kanë planifikuar se si të shkojnë tek televizioni ... që të bisedojnë me V.S. për t'ia tërhequr vërejtjen lidhur me këto postime, ku pastaj kanë marrë veturën e L.D. e tipit "BMW", ngjyrë e zezë, dhe që të tre kanë shkuar tek objekti i televizionit

..., ku kanë hyrë në parking të objektit ku ishte edhe një kafe, ku janë ndaluar dhe kanë pritur derisa V.S. ka dalur nga televizioni se bashku me një person tjetër dhe ka hyre në veturën e personit në fjalë, të cilën veturë e kanë përcjellë nga mbrapa deri në një kafiteri në "...", ku janë ndalur dhe pas tyre janë ndalur edhe këta dhe kanë dalur nga vetura, ku L.D. e ka thirr V. duke i thënë: "Ndal veç pak", dhe V. ka filluar të ikë dhe duke vrapuar është rrëzuar, ku pastaj unë së bashku me L.D. kanë filluar ta godasin me grushte dhe shuplaka, ku gjatë goditjeve më ka rënë ora e dorës në tokë dhe më ka mbetur në vendin e ngjarjes. Pastaj, kanë dalur disa persona nga kafiteria dhe kanë filluar të ikun, të cilët persona e kanë sulmuar, ndërsa në deklaratën e të pandehurit O.H. të dhëna në PSRK me datë 24.07.2023, në të cilën ka deklaruar se nuk e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë Nxitja e përçarjes apo mos durimit, dhe se deklarata e dhënë në polici nuk është kreu e saktë sepse ka qenë i ndikuar emocionalisht, për këtë arsye edhe e ka refuzuar ta nënshkruaj procesverbalin, më pas ka deklaruar se me datë 11.04.2023 ka qenë në F. K. me vëllain e tij K. dhe shokun e tij L.D., ku bashkërisht kanë vendosur për shkuar në te televizioni ... për ta takuar V.S. me qëllim që të bisedojnë me të lidhur me ofendimet ndaj komunitetit mysliman, kanë shkuar me veturën e L. dhe kanë pritur diku rreth 15-20 minuta tek ... dhe pastaj e kanë parë me veturë V.S. duke u nisur dhe e kanë përcjellë deri tek ..., te kafiteria "...", ku kemi dal me fole dhe shoku i tij L.D. e ka thirr: "Ndal veç pak", dhe V. ka filluar me fol diçka dhe ka vrapuar në drejtim të kafiterisë, ku ka dalur nga kontrolli dhe e ka ndjekur V. dhe e ka sulmuar duke e goditur, ndërsa për L. dhe K. ka deklaruar se nuk e dinë çfarë veprime kanë ndërmarr, pastaj, kanë tentuar të largohen dhe ndaj tyre kanë filluar të sulmojnë rreth 4-5 persona me mjete të forta si gurë dhe gajbe të birrave, duke ua dëmtuar edhe veturën dhe duke tentuar ti hapin dyert e veturës, sqaron se te televizioni ... nuk kanë mundur të bisedojnë me V. se ka pasur shumë njerëz dhe kanë dashur të bisedojnë më privatisht me të, pasi që bisedat që kanë pasur të zhvillojnë me V. ka qenë me pyet për fyerjen ndaj Profetit Muhammed dhe Isa, duke e ditur që shumica e popullatës në Kosovë e praktikojnë fenë islame dhe kjo është ofendim për ta, më pas ka deklaruar se i vjen keq për atë që ka ndodhur dhe është zotuar se në të ardhmen nuk do të ndodhë nga ana e tij kurrë far veprimi.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit O.H., nga e njëjta vërtetohet se në natën kritike me vëllain e tij K. dhe shokun e tij L.D., ku bashkërisht kanë vendosur për shkuar në te televizioni ... për ta takuar V.S. me qëllim që të bisedojnë me të lidhur me ofendimet ndaj komunitetit mysliman, kanë shkuar me veturën e L. dhe kanë pritur diku rreth 15-20 minuta tek ... dhe pastaj e kanë parë me veturë V.S. duke u nisur dhe e kanë përcjellë deri tek ..., te kafiteria "...", ku kemi dal me fole dhe shoku i tij L.D. e ka thirr: "Ndal veç pak", dhe V. ka filluar me fol diçka dhe ka vrapuar në drejtim të kafiterisë, ku ka dalur nga kontrolli dhe e ka ndjekur V. dhe e ka sulmuar duke e goditur, gjykata gjen se mbrojtja e tij është reale dhe objektive, i pohon të gjitha veprime inkriminuese si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, gjykata gjen se sipas të pandehurit të lartcekur deklaroi "shoku i tij L.D. e ka thirr: "Ndal veç pak", dhe V. ka filluar me fol diçka dhe ka vrapuar në drejtim të kafiterisë", nuk ka deklaruar se i dëmtuari V.S. i ka ofenduar me ndonjë fjalë, si ka deklaruar i pandehuri L.D. në mbrojtjen e tij, andaj gjykata gjen se e njëjta mbrojtje gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarëve V.S. dhe I. M. të ndërgjuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale.

Gjykata, këto deklaratat i ka trajtuar si prova të drejtpërdrejta, por duke mos i shpallur fajtor të pandehurit vetëm mbi këto deklaratat si dhe duke mos iu dhënë rëndësi vendimtare vetëm këtyre deklaratave. Kjo në pajtim me nenin 256 të KPPRK-së ku përcaktohet se: ” *Deklarimi i të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit të shtetit mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim me dispozitat e nenit 74, paragrafi 2, nenit 128 ose nenit 129 dhe në pajtim me nenet 149 deri 153 të këtij Kodi. Deklaratat e tilla mund të përdoren për ta kundërshtuar deklarimin e të pandehurit në gjyq ose si provë e drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 257 paragrafin 2 të këtij Kodi*”, lidhur me nenin 257 par.2 ku përcaktohet se: “ *Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklarimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit*”.

Analiza dhe vlerësimi i provave të administruara

- Provat personale

Gjykata, si prova personale në këtë shqyrtim gjyqësor ka administruar deklaratën e të dëmtuarit të n dëgjuar në cilësi të dëshmitarit V.S. si dhe deklaratën e dëshmitarit I. M.

Dëshmitari V.S. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 23.11.2023 ka deklaruar se qëndron pas deklaratës së dhënë në polici dhe se në natën kritike ka qenë i ftuar në televizionin ... si panelist dhe diku afër orës 22:00, ka përfunduar emisionin dhe me koleget e emisionit janë dakorduar që të vazhdojnë pas debatit për një pije diku në qytet, moti nuk ka qenë i mirë atë natë, shpejt kanë hyrë në vetura, ku ai ka hyrë në veturë me I. M., ndërsa L. K. me “Audi” është nisur drejt qendrës së P., fillimisht, nuk e kanë caktuar lokacionin për të shkuar, por përmes “whatsapp” janë dakorduar që në kafiterinë “...” në ... në P., kur kanë arritur të kafiteria kanë dalur shpejt nga vetura që të futen në kafiteri, dhe me të arritur pranë kafiterisë një person me dukje islamik radikal fundamentalist L.D., e ka thirr nga mbrapa dhe i ka thënë: ‘ *mfal a bon veç pak qetu*’, është kthyer e ka parë dhe nuk ka thënë asgjë dhe shpejt ka tentuar të futet në lokal, dhe duke qenë kubëzat e lagështa ku e ka humbur balancën dhe aty është goditur nga mbrapa në kokë nga L.D. dhe pastaj dy personat e tjerë as që i ka parë se ka qenë i rrezuar në shkallë të lokalit dhe vetëm ka bërë për ndihmë, e ka vërejtur se është goditur edhe nga persona të tjerë, por nuk i ka identifikuar pasi që e ka mbrojtur fytyrën dhe goditjet i ka marrë në pjesën e sipërme të kokës, dikush nga sulmuesit ka poseduar një orë digjitale e madhësisë standarde me teha metalik dhe duke e grushtuar në kokë rrëshqitja e orës e ka goditur në pjesën anësore të ballit nga ka ardhur e gjithë gjakderdhja, pastaj, kolegu I. M. e ka tërhequr nga pas njërin nga ta duke e kapur nga dora apo krahu dhe e mban që të mos sulmojë dhe dalin persona nga kafeneja për i ndihmuar, ku më pas të pandehurit janë tërhequr, është futur brenda dhe ka shkuar në banjo pasi që kishte shumë gjak i cili nuk ndalej, ku pastaj një mik ia ka sjellë një orë, por që i ka thënë se nuk është e tij, por e sulmuesve, pas diku rreth 10 minutave ka arritur policia së bashku me ndihmën e shpejtë, të cilët edhe e kanë marrë në pyetje, dikush nga kafeneja i ka marrë numrin e tabelave të veturës së të pandehurve, të cilin numër e ka dorëzuar në polici, në sulm kane qene te përfshirë të tre të pandehurit, njeri nga vëllezërit Hasani e ka pasur orën dhe është i bindur se të dy vëllezërit e kanë goditur, mendon që të pandehurit i kane përcjellë kur kanë dalur nga emisioni sepse nuk e kanë dite se në cilën kafe po shkojmë, dy personat tjerë ka deklaruar se nuk

i ka parë në fytyrë, por vetëm nga anash dhe e dinë që kanë qenë 3 persona L.D. dhe dy tjerë krahas tij, dhe sikur të mos ishte I. M. sulmi do të vazhdonte, ka shtuar se në atë dite ka qene një lajm ku një hoxhë i P. shpërblehet me “Mercedes”, dhe postimi i tij i parë ka qene kritik se si një hoxhë po shpërblehet me mercedes nga xhemati dhe BIK, ne muajin e shenjte të Ramazanit ku duhet të promovohet modestia, me një dhurate tepër luksoze. Pra, kritika ka qenë se hoxhallarët si njerëz të show bizit, e jo si prijës fetar dhe pas kësaj ka pasur edhe një barcolet për profetin Isa dhe Muhamedin, kjo batutë lidhet me veturën e cila tregon se Profeti Muhamed e sheh në parajsë Profetin Isa(Jezu Krishtin) me një veturë të shtrenjtë luksoze dhe pyet qysh ju keni një veturë të shtrenjtë e unë jo, dhe i njëjti i thotë se unë jam i biri i Zotit, batutat e tilla, me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës nuk përbëjnë krim, por liri edhe kreativitet dhe kush preket nga kjo është çështje tjetër. Më pas deklaroi se kur i pandehurit ju ka drejtuar ‘*a bon veç pak qetu*’, i njëjti është përgjigjur se pamja e të pandehurit, pozita e trupit e aktivizuar në forme të kanosje e cila nuk ishte e relaksuar, dukej sikur përgatitje për kanosje dhe sulm dhe nuk kishte ton miqësor që përdorej, dritat e kafiterise kane qene dhe ka mundur me pa, nuk ka qene errësirë pasi qe dritat dhe pamja ka qene shumë e mirë dhe ka qenë terr se ka qene kohe e mbrëmjes, gjatë rrugës për në lokalin ‘...’ ka deklaruar se nuk ka vërejte diçka, por pasi qe ka ndodh krejt rasti I. i ka thënë se mu ka doke sikur dikush po i përcjell. Ka shtuar se rastin e ka përjetuar rendë, është presion për të pasi që shkakton pasiguri ne lëvizje dhe duhet të mbyllesh, të cenohet lëvizja sepse mund të ndodh përsëri, pasi që sulmi është i organizuar dhe ka tendenca terroriste me qëllim të frikësimit të njerëzve të opinionit publik, mediave dhe masës popullore, pasi që në këtë gjykate të pandehurit nuk e respektojnë këtë gjykate dhe kjo vërteton tendencën ekstremiste të tyre. Ndërsa deklarata e dhënë në polici me datë 29.05.2023, ka deklaruar se dëshmitari Ilir Morena ka arritur ta largoj njërin nga personat që më ka sulmuar, ndërsa dy persona tjerë kanë vazhduar që të më godasin ndërkohë, ndërsa pjesa tjerë e deklaratës është e njëjtë me deklaratën e dhënë në shqyrtim gjyqësor nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata vlerëson deklaratën e dëshmitarit V.S., nga e njëjta vërtetohet se në natën kritike, (i cili paraprakisht kishte vendosur disa batuta në rrjetin e tij social në facebook lidhur me fenë islame) pas përfundimit të emisionit në televizion ..., dhe duke hyrë në kafiterinë ‘...’ tek ‘...’ është sulmuar nga tre të pandehurit, është vërtetuar se me të arritur pranë kafiterisë i pandehuri L.D., e ka thirr nga mbrapa me një ton jo miqësor dhe i ka thënë: ‘*mfal a bon veç pak qetu*’, është kthyer e ka parë të pandehurin në një pozitë të trupit të aktivizuar sikur përgatitje për kanosje dhe sulm dhe nuk ka thënë asgjë dhe shpejtë ka tentuar të futet në lokal, dhe duke qenë kubëzat e lagështa e ka humbur balancën dhe aty është goditur nga mbrapa në kokë nga L.D. dhe pastaj dy personat e tjerë, të cilët nuk i ka parë, është i sigurve që e kanë goditë tre persona, se ka qenë i rrezuar në shkallë të lokalit dhe vetëm ka bërëtitur për ndihmë, ku pastaj kolegu I. M. e ka tërhequr nga pas njërin nga ta duke e kapur nga krahu dhe e mban që të mos sulmojë dhe dalin persona nga kafeneja për i ndihmuar, ku më pas tre të pandehurit janë tërhequr, andaj gjykata gjen se e njëjta dëshmi gjen mbështetje në dëshmon e dëshmitarit I. M. të ndërgjuar në këtë çështje penale, në mbrojtjen e të pandehurve si dhe në provat materiale, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale dhe të sinqertë.

Dëshmitari I. M., në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 23.11.2023 ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 30.05.2023, në natën kritike ka deklaruar

se ka qenë në emision në ... dhe pas debatit disa miq u kane treguar se janë në një kafe ku shkojnë shpesh dhe kanë vendosur me shkuar, kanë shkuar me veturën e tij ku me të ka qenë edhe V.S., ndërsa drejtori i ... L. ka qenë me veturën e tij, kanë shkuar ne kafiterin "Image", që është larg dikur rreth 5-6 km, kur kanë mbërritur te kafiteria "... " nuk ka pas parking dhe veturën e kanë lënë pak me larg dhe kanë dal prej veturë, ku V. ka dal i pari ka qenë 10 hapa para tij dhe në atë rast ka dëgjuar disa hapa duke vrapuar pas tij dhe pastaj V. ka filluar të vrapojë deri te hyrja e restorantit ku edhe e kanë sulmuar duke e rrëzuar dhe pastaj duke e goditur në pjesën e kokës, Pastaj jam afruar dhe njërin prej tyre e ka kapur nga mbrapa dhe e ka larguar nga V., të cilët pastaj kanë ikur, ndërsa V. ka mbetur i përgjakur. Ka shtuar gjatë rrugës për të shkuar nga ..., deri tek kafiteria "... " e ka vërejtur që një veturë po i rrinë afër gjatë gjithë kohës, por nuk i ka kushtuar vëmendje pasi që ka menduar se është L., pasi që në natën kritike, ka deklaruar se ka qenë gjysmë errësirë sepse ka pasur ndriçim, në momentin kur kanë kaluar personat duke vrapuar në natën kritike, kanë qene tre persona, ndërsa mbi trupin e V. i ka parë vetëm dy persona, detajet nuk i ka parë se ka qene punë sekondash. Ndërsa deklarata e dhënë në polici me datë 30.05.2023, ka deklaruar se kemi shkuar së bashku me V. tek kafiteria ..., pasi që e kamë parkuar veturën, i kamë vërejtur tre persona që na kanë thënë diçka por nuk më kujtohet saktë se çfarë, e kanë mbërri V. tek shkallët e lokalit dhe kanë filluar ta godasin, kamë vrapuar dhe e kamë larguar njërin nga sulmuesit ndërsa dy tjerët kanë ikur, ndërsa pjesa tjetër e deklaratës është e njëjtë me deklaratën e dhënë në shqyrtim gjyqësor nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit I.M., ka vërtetuar që i njëjti ka qenë në emision së bashku me të dëmtuarin V.S. dhe pas emisionit me veturën e tij kanë shkuar për pije në kafiterinë "...", ku gjatë rrugës ka vërejtur se një veturë po i rrinë afër gjatë gjithë kohës, por nuk i ka kushtuar vëmendje pasi që ka menduar se është L. -drejtori i Me të arritur tek kafiteria "...", V. ka dal i pari nga vetura dhe ka qenë 10 hapa para tij dhe në atë rast ka dëgjuar disa hapa duke vrapuar pas tij dhe pastaj V. ka filluar të vrapojë deri te hyrja e restorantit ku edhe e kanë sulmuar duke e rrëzuar, kanë qenë tre persona, ndërsa mbi trupin e V. i ka parë vetëm dy persona duke e goditur në pjesën e kokës, ku ky dëshmitar është afruar dhe njërin prej tyre e ka kapur nga mbrapa dhe e ka larguar nga V., të cilët pastaj kanë ikur, ndërsa V. ka mbetur i përgjakur, andaj gjykata gjen se e njëjta dëshmi gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit V.S. të ndëgjuar në këtë çështje penale, në mbrojtjen e të pandehurve si dhe në provat materiale, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si reale dhe të sinqertë.

Provat materiale

Gjykata, gjatë shqyrtimit kryesor ka administruar provat si në vijim:

Nga raporti informues i Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë me nr .ref: 06/1-03/86-2023, datë 12.04.2023 bashkangjitur po ashtu edhe raporti i shpejtë me përshkrimin e vendit të ngjarjes me nr. 2023 –AD -1261 të datës 11.04.2023, gjykata vërteton se me datë 11.04.2023 rreth orës 22:45 tre persona e kanë sulmuar të dëmtuarin V.S. duke i shkaktuar lëndime në kokë dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes me veturën BMW, ngjyrë e zezë, me targa ...

Nga raporti fillestarë i incidentit i Policisë së Kosovës në Prishtinë me nr. të rastit 2023- AD-1261 të datës 11.04.2023, gjykata ka vërtetuar se me datë 11.04.2023, në ora 22:39 është raportuar për incident në P., në rrugën “...” tek lokali”...”, dhe policia në vendin e ngjarjes ka arritur në ora 22:58, e nga i cili incident ka pasur lëndime të lehta trupore i dëmtuari V.S.

Nga fletëthirrja e Ndhimës së shpejtë mjekësore se bashku me konstatimin e mjekut datë 11.04.2023, gjykata vërteton se është thirrur ndihma e shpejtë me datë 11.04.2023 në ora 22:50, ku ndihma e shpejt ka shkuar në ora 22:55 dhe ka gjetur të dëmtuarin V.S. në plagë të hapur – gjakderdhje në anën e djathtë të kokës, ku i është bërë fashimi i plagës dhe është transportuar në Qendrën e Klinikës Emergjente.

Nga flete lëshimi i mjekut nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Klinika Emergjente në Prishtinë me nr. të protokollit 23393 të datës 11.04.2023, vërtetohet se i dëmtuari V.S. është dërguar me urgjencë në këtë klinikë për shkak të lëndimit të kokës pas incidentit fizik.

Nga raporti njoftues i Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref; 06/1-03/12-2023 datë 06.06.2023, mbi analizimin e ekzaminimit të pajisjes (aparitit telefonik) i sekuestruar nga i pandehuri L.D., gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari L.D. përmes rrjeteve sociale ka komunikuar me persona të ndryshëm rreth armëve të zjarrit, si dhe janë gjetur komunikime janë shkëmbyer edhe disa fotografi të tyre dhe dy video të ushtrave të organizatave terroriste të cilat operojnë në shtetet e lindjes se mesme dhe bisedohet rreth botimit të një reviste e cila është në gjuhën angleze ku’’ shteti islamik e sqaron akiden’’. Po ashtu, është gjetur një komunikim ku është dërguar një fotografi ku shihen dy ushtarë të armatosur, ku njeri nga ta thuhet se është P. M. me noftken’’E. M.’’. Po ashtu, ka zhvilluar komunikime, në të cilat është dërguar edhe një fotografi e L. M., ku i akuzuari shprehet: ‘’Me dal me gju me kallash, Allahu na mundësoftë me gjuajt ne kon duhet’’. Po ashtu, nga administrimi i kësaj prove janë gjetur fotografi ku shihet i akuzuari L.D. fotografuar ne oborrin e tij me armë automatike AK47, si dhe me flamur të ISIS-i.

Nga akt ekspertimi mjeko ligjor në bazë të dokumentacionit të çështjes lëshuar nga Specialisti i Mjekësisë Ligjore- IML në Prishtinë me nr ref: Pr- 75, datë: 24.05.2023 për të dëmtuarin V.S., gjykata ka vërtetuar që i dëmtuari me rastin e sulmit ka pësuar ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kokës dhe qafës, si dhe plagës shquese ndrydhëse në regjionin tëmthoro-ballor të anës së djathtë të kokës, të cilat dëmtime janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, mbrretës(jo të mprehtë), e të cilat dëmtime bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme në shëndet.

Nga shikimi dhe vlerësimi i CD - barcoleta e postuar në video nga i dëmtuari V.S., gjykata ka vërtetuar faktin se i dëmtuari V.S. në rrjetin e tij social në facebook, ka postuar një video të llojit sarkazëm që ndërlihet me rastin kur një imam i Kosovës ka pranuar një dhuratë nga xhemati i tij. Në këtë video i dëmtuari V.S. shprehet:’’ Nëse të pyesin se kush është krijuesi yt, ti thuaj Allahu Xheleshannehu, nëse të pyesin kush është pejgamberi yt, ti thuaj Muhammedi Alejiselam, nëse të pyesin kush është udhërrëfyesi yt, ti thuaj Kurani i krijimit, ndërsa kur të pyesin se cilin kerr ti e don, ti thuaj mercedes’’. I dëmtuari V.S., ka postuar në rrjetin e tij në facebook një batutë

që ndërlidhet me fenë islame, respektivisht me Profetin Muhammed dhe Profetin Isa(Jezu Krishti) me përmbajtjen si në vijim: ‘ Profeti Muhamed e sheh në parajsë Profetin Isa(Jezu Krishtin) me një veturë të shtrenjtë luksoze dhe pyet qysh ju keni një veturë të shtrenjtë e unë jo, dhe i njëjti i thotë se unë jam i biri i Zotit’.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me faktet kontestuese dhe jokontestuese

Faktet jokontestuese

Gjykata, ka konstatuar se nuk ishte kontestues fakti se me datë 11.04.2023 rreth orës 23:00 ka ndodhur një përleshje ku kanë qenë të përfshirë të pandehurit L.D., O.H. dhe K.H. dhe i dëmtuari V.S., e që në vend të ngjarjes ka qenë edhe dëshmitari I.M.. Faktin, se të pandehurit e lartcekur kanë qenë të përfshirë në përleshje, nuk e mohon asnjëri nga ta, të cilët njëkohësisht nuk i mohojnë as veprimet e ndërmarra ndaj të dëmtuarit V.S.

Po ashtu, nuk është fakt kontestues që nga kjo përleshje, i dëmtuari V.S. ka marrë lëndime trupore, të cilat sipas ekspertizës kanë rezultuar të jenë të natyrës se lehtë trupore.

Tutje, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese se i dëmtuari V.S., ka postuar në rrjetin e tij në facebook një batutë që ndërlidhet me fenë islame, respektivisht me Profetin Muhammed dhe Profetin Isa(Jezu Krishti) me përmbajtjen si në vijim: ‘ *Profeti Muhamed e sheh në parajsë Profetin Isa(Jezu Krishtin) me një veturë të shtrenjtë luksoze dhe pyet qysh ju keni një veturë të shtrenjtë e unë jo, dhe i njëjti i thotë se unë jam i biri i Zotit*’.

Gjykata, ka gjetur po ashtu se nuk është kontestuese që i dëmtuari V.S. në rrjetin e tij social në facebook te këtë postuar edhe një video të llojit sarkazëm, që ndërlidhet me rastin kur një imam i Kosovës ka pranuar një dhuratë-veturë të tipit mercedes nga xhemati i tij. Në këtë video i dëmtuari V.S. shprehet: ‘ *Nëse të pyesin se kush është krijuesi yt, ti thuaj Allahu Xheleshannehu, nëse të pyesin kush është peygamberi yt, ti thuaj Muhammedi Alejiselam, nëse të pyesin kush është udhërrëfyesi yt, ti thuaj Kurani i krijimit, ndërsa kur të pyesin se cilin kerr ti e don, ti thuaj mercedes*’.

Faktet kontestuese

Gjykata, si fakte kontestues në këtë çështje penale, ka gjetur: nëse ka ekzistuar bashkëkryerja mes të pandehurve për kryerjen e veprës penale; motivi i kryerjes së kësaj vepre penale, pra nëse kjo vepër penale është kryer motivuar nga besimi fetar; nëse ka ekzistuar dashja për kryerjen e kësaj vepre penale, respektivisht nëse ekziston dashja lidhur me elementin kualifikues, e që është lëndimi i lehtë trupor i shkaktuar motivuar nga besimi fetar.

- Lidhur me ekzistimin e bashkëkryerjes

Këtë fakt kontestues e ka ngritur mbrojtësja e të pandehurit L. D., e cila në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: ‘...nga dëgjimi i dëshmitarit I.M. vërtetohet se i dëmtuari është goditur nga dy persona, e jo nga tre siç pretendon prokuroria’.

Gjykata, pas analizimit të gjitha provave materiale dhe personale, ka gjetur se të pandehurit e lartcekur kanë vepruar në bashkëkryerje dhe ky fakt vërtetohet nga dëgjimi i të dëmtuarit V.S. në cilësi të dëshmitarit, në deklaratën e dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: ‘*në sulm kane qene të përfshirë të tre të pandehurit*’, pastaj nga dëgjimi i dëshmitarit I.M., në deklaratën e dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: ‘*Në momentin kur kanë kaluar personat duke vrapuar në natën kritike, kanë qene tre persona, ndërsa mbi trupin e V.t i ka parë vetëm dy persona. Detajet nuk i ka parë se ka qenë punë sekondash*’. Po ashtu, fakti që të tre të pandehurit kanë vepruar në bashkëkryerje vërtetohet edhe nga deklaratat e dhëna nga vetë të pandehurit në procedurë paraprake. I pandehuri L.D. në deklaratën e dhënë në prokurori ka deklaruar se: ‘*nuk e mohoj faktin që V. e kemi sulmuar që të tretë, por se deklaroj vetëm për veprimet e mija*’. Po ashtu, i pandehuri K.H. në deklaratën e dhënë në prokurori ka deklaruar se: ‘*që të tretë e kemi sulmuar V. me grushte*’. Edhe i pandehuri O.H. në deklaratën e dhënë në prokurori e ka pranuar se e ka sulmuar të dëmtuarin V.S., ashtu që ka deklaruar se: ‘*...kam dalur nga kontrolli dhe e kam ndjekur V.n dhe e kam sulmuar duke e goditur*’.

Gjykata, deklarimeve të tilla ua fali në tërësi besimin pasi që të gjitha deklaratat janë në përputhje me njëra tjetrën. Edhe deklarata e dëshmitarit I.M., ku ka deklaruar se: ‘*mbi trupin e V. i ka parë vetëm dy persona*’, nuk është në kundërshtim me deklaratat e tjera, pasi që ky dëshmitari për asnjë moment nuk e ka mohuar që të tre të pandehurit kanë mundur ta kenë sulmuar të dëmtuarin V.S., por meqë ka qenë punë sekondash ka parë vetëm dy nga ta mbi V. duke e sulmuar, ku paraprakish ka deklaruar se ‘*Në momentin kur kanë kaluar personat duke vrapuar në natën kritike, kanë qene tre persona*’ në drejtim të dëmtuarit V.S., nga të lartcekurat gjykata vërteton se të pandehurit L.D., O.H. dhe K.H. kanë vepruar në bashkëkryerje për kryerjen e veprës penale, për të cilën janë shpallur fajtor dhe janë dënuar në bazë të ligjit.

- Lidhur me motivin e kryerjes se veprës penale

Këtë fakt kontestues e kanë ngritur të gjithë mbrojtësit e të pandehurve, por edhe vetë të pandehurit, të cilët i kanë pranuar veprimet e tyre, por nuk e kanë pranuar motivin e kryerjes së kësaj vepre penale.

Gjykata, pas analizimit të gjitha provave personale dhe materiale, ka konstatuar se sulmi, që ka rezultuar me lëndime të lehta trupore, nga të pandehurit L.D., O.H. dhe K.H. është motivuar nga besimi fetar, dhe një fakt i tillë ka bërë që kjo vepër penale të kualifikohet sipas par.3 të nenit 185 të KPRK-së.

Faktin se sulmi që është kryer ndaj të dëmtuarit V.S., e që ka rezultuar me lëndime të lehta trupore është motivuar nga besimi fetar, gjykata e ka vërtetuar duke marrë për bazë postimet në facebook të të dëmtuarit V.S., e që kanë qenë të ndërlidhura me fenë islame, respektivisht

Profetin Muhammed dhe Isa. Të pandehurit gjatë gjithë deklaramëve të tyre të dhëna në procedurë paraprake, kanë theksuar faktin se janë ndier të fyer nga postimet e të dëmtuarit V.S. dhe kanë vendosur të dalin për të pirë kafe dhe të diskutojnë për këtë, e pastaj edhe kanë vendosur bashkërisht që të shkojnë të V.S. për të biseduar, e pastaj ka ndodhur edhe sulmi. Kështu, i pandehuri L.D. në deklaratën e dhënë në prokurori ka deklaruar se: *” në mbrëmjen kritike pas iftarit është takuar me K. dhe O.H. për të pirë kafe, ku pastaj kanë vendosur bashkërisht që të shkojnë n’... për të biseduar me V.S. lidhur me postimet e tij fyese ndaj pejgamberit Muhammed dhe Isa, pasi që e kanë parë se është drejtpërdrejt në emision. Kur kanë shkuar tek ... nuk kanë mundur ta takojnë V. sepse i njëjti ka hyrë në veturë menjëherë te një person tjetër, andaj e kanë përcjellur deri kur ka zbritur në ... – kafiteria ...”*, tuje i pandehuri tjetër K.H. në deklaratën e tij të dhënë në prokurori ka deklaruar se: *“ me datë 11.04.2023 e kanë thirr O. dhe L. për të dal për kafe dhe gjatë rrugës ka ra për diskutim çështja e V.S. lidhur me postimet e tij në rrjetet sociale me përmbajtje fyese ndaj profetit Muhammed dhe Isa dhe kanë vendosur që të shkojnë për të biseduar me V. dhe për t’ia tërhequr vërejtjen që të mos bëjë postime të tilla duke qenë se është edhe muaji i Ramazanit dhe mundësisht t’i fshijë ato postime”*. Po ashtu, edhe i pandehuri O.H. në deklaratën e dhëna në polici ka deklaruar se: *“ se ka parë edhe një video të V. S. ku shihet personi në fjalë duke u tallë me fenë islame. Me të parë këto dy postim si pjesëtarë i besimit islam është ndier tepër i ofenduar dhe i lënduar dhe ka komunikuar me L.D. ku e kanë lënë që të takohen pas iftarit në F. K., afër marketit ”...”*, diku rreth orës 21:00 janë takuar dhe kanë vazhduar tek mobileria ‘...’, në F. K., ku aty i është bashkuar edhe vëllai i tij K.H., ku edhe kanë biseduar rreth postimeve të publikuara nga gazetari V.S., me të cilat postimet janë të ndier të ofenduar edhe L. dhe K. Kanë planifikuar se si të shkojnë tek televizioni ... që të bisedojnë me V.S. për t’ia tërhequr vërejtjen lidhur me këto postime”, e po ashtu në deklaratën e dhënë në prokurori ka theksuar se: *“deklarata e dhënë në polici nuk është krejt e saktë sepse ka qenë i ndikuar emocionalisht, për këtë arsye edhe e ka refuzuar ta nënshkruaj procesverbalin. Ndërsa në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 11.04.2023 ka deklaruar se ka qenë në F. K. me vëllain e tij K. dhe shokun e tij L.D., ku bashkërisht kanë vendosur për shkuar në ... për ta takuar V.S. me qëllim që të bisedojnë me të lidhur me ofendimet ndaj komunitetit mysliman”*.

Nga këto deklarime të dhëna vërtetohet se të pandehurit L.D., O.H. dhe K.H. janë ndier të fyer nga postimet e të dëmtuarit V.S. në rrjetin social në facebook, e të cilat postime kanë qenë të ndërlihdura me çështje fetare, respektivisht me Profetin Muhammed dhe Isa, dhe një fakt i tillë bënë që kjo vepër të jetë kryer për arsye të motiveve fetare, kjo duke marrë parasysh edhe qëllimin e të pandehurve të lartcekur është që t’ia kufizojnë një të drejtë kushtetuese të dëmtuarit V.S. dhe atë lirinë e shprehjes.

Kjo për arsye se, i dëmtuari V.S., me rastin e publikimit të këtyre postimeve ka vepruar në kuadër të autorizimeve kushtetutës, të drejtave fundamentale të cilat i gëzon secili individ. Me postimet e tilla, i dëmtuari V.S. nuk i ka cenuar asnjë të drejtë personave të tretë, vetëm e ka shfrytëzuar të drejtën e tij që të shprehet lirshëm. Liria e shprehjes në Kosovë paraqitet si kategori kushtetuese(pra, gëzon mbrojtje edhe nga kushtetuta si akti më i lartë), ku në nenin 40 përcaktohet se: *“Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush”*. Një e drejtë e tillë parashihet edhe me Konventën Evropiane për të

Drejatat e Njeriut, ku në nenin 10 (par.1) të saj është përcaktuar liria e shprehjes, ku thuhet se: *‘Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë’*. Liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike, një nga kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo qenieje njerëzore. Ose, Shtypi luan një rol të spikatur në një vend të qeverisur nga shteti ligjor (Udhëzues për implementimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut). Po ashtu, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përcaktohet parimi i laiciteti në çështjet e besimit fetar, ku në nenin 8 përcaktohet se: *‘Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare’*. Me nenin 38 të Kushtetues së Republikës së Kosovës përcaktohet se: *‘Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar(par.1)’* dhe *‘Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ngërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar’* (par.2). Po ashtu, në nenin 58 ku përcaktohen përgjegjësitë e shtetit, në par.3 përcaktohet se: *‘Republika e Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t’u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar’*.

Nga analizimi i dispozitave si më lartë konstatohet se liria e shprehjes në Kosovë është e garantuar dhe kjo e drejtë e përfshin lirinë e pasjes së mendimit personal, marrjes dhe dhënies së informatave dhe të ideve pa ndërhyrje të pushtetit publik dhe pa marrë parasysh kufijtë. Është e drejtë e njeriut që lirisht të mendojë dhe që publikisht t’i shprehë mendimet, qëndrimet dhe bindjet e veta. Ai mund të mendojë çfarë të dëshirojë dhe nuk duhet të dënohet apo të shqetësohet për shkak të përmbajtjes së mendimeve të tij (edhe përkundër asaj që ato mendime janë të papranueshme për të tjerët).

Liria e shprehjes është e garantuar edhe në aspekt të çështjes së besimit (fesë), ashtu që, çdo qytetar lirisht mund t’i përkasë cilësdo fe, që besimin e tij mund ta përshtatë sipas mësimave të cilësdo fe, jo vetëm të pranuar, por edhe të papranuar. Ashtu, siç është e garantuar edhe *Liria e ndërgjegjes*, që nënkupton që qytetari nuk është i lidhur me mësimet e cilësdo fe në çështjet themelore të shikimit të botës. Ai mund të mos e pranojë cilëndo pikëpamje për dukuritë në kozmos, por që të ketë pikëpamje të vet personale. Praktikisht, kjo do të thotë se ai mund të mos i përkas asnjë feje, sepse ateizmi është juridikisht i mundshëm(*Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës*).

Asnjë qytetarë nuk mund ta vendos vetën në pozitë më të volitshme sesa qytetarët e tjerë vetëm sepse i takon një feje tjetër, dhe në këtë mënyrë askush nuk mund të lirohet nga obligimet e tij shtetërore duke iu referuar besimit fetar sepse rregullat fetare nuk mund të vendosen mbi dispozitat ligjore pozitive(*Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës*).

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, del që të pandehurit L.D., O.H. dhe K.H. kanë vepruar të motivuar fetarisht, me rastin e sulmit ndaj të dëmtuarit V.S., duke dashur që me këtë rast normat religjioze-fetare t'i vendosin mbi normat ligjore të aplikueshme dhe një gjë e tillë vërtetohet nga deklarimi i të akuzuarit O.H., i cili ka deklaruar se: *“Kanë planifikuar se si të shkojnë tek televizioni ... që të bisedojnë me V.S. për t'ia tërhequr vërejtjen lidhur me këto postime”*. Pra, nga kjo vërtetohet që të pandehurit e lartcekur kanë pasur si qëllim që të dëmtuarit V.S., t'ia kufizojnë një të drejtë kushtetuese, e që është liria e shprehjes, dhe kështu normat religjioze të vendosen para atyre shtetërore-kushtetuese. Një tendencë e tillë, nga të pandehurit e lartcekur është shprehur edhe gjatë gjithë gjykimit, ku të njëjti nuk e kanë respektuar gjykatën, kanë deklaruar një zëri se nuk duam të gjykojmë nga gjykata me këto ligje, por vetëm në bazë të ligjeve të Allahut, duke mos e njohur si institucion gjykatën, e po ashtu duke mos i pranuar mbrojtën-avokatët.

- Lidhur me ekzistimin e dashjes lidhur me elementin kualifikues, e që është lëndimi i lehtë trupor i shkaktuar motivuar nga besimi fetar.

Gjykata, pas analizimit të gjitha provave materiale dhe personale të administruara, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi që lëndimet trupore të dëmtuarit V.S. i janë shkaktuar nga të pandehurit e lartcekur, pasi që një fakt i tillë është pohuar edhe nga mbrojtja, por edhe deklaratat e dhëna nga vetë të pandehurit në procedurë paraprake të cilët për asnjë moment nuk i kanë mohuar veprimet e tyre, respektivisht nuk e kanë mohuar faktin se e kanë sulmuar të dëmtuarin V.S.

Kontestues ka qenë fakti nëse ekziston dashja lidhur me elementin kualifikues, e që është lëndimi i lehtë trupor i shkaktuar motivuar nga besimi fetar, pasi që nga mbrojtja pretendohet që të pandehurit janë provokuar nga i dëmtuari, andaj edhe e kanë sulmuar, e jo për shkak të motiveve fetare.

Po ashtu, të pandehurit kanë deklaruar se kanë pasur për qëllim që të shkojnë dhe të bisedojnë me të dëmtuarin V.S. lidhur me postimet e bëra lidhur me Profetin Muhammed pasi janë ndier të fyer, dhe nuk e kanë pranuar faktin se të njëjtit kanë shkuar për ta sulmuar të dëmtuarin.

Megjithatë, gjykata nga administrimi i provave, ka gjetur se te të pandehurit ka ekzistuar dashja direkte dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë që të bisedojnë, por që ta sulmojnë të dëmtuarin V.S., dhe një fakt të tillë gjykata e ka vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe deklaratat e dhëna nga vetë të pandehurit në procedurë paraprake. Kështu, i dëmtuari V.S., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: *“i pandehuri L.D., e ka thirr nga mbrapa me një ton jo miqësor dhe i ka thënë: ‘mfal a bon veç pak qetu’, është kthyer e ka pare të pandehurin në një pozitë të trupit të aktivizuar sikur përgatitje për kanosje dhe sulm dhe nuk ka thënë asgjë dhe shpejtë ka tentuar të futet në lokal, ku edhe e kanë sulmuar më pas”*. Po ashtu, dëshmitari tjetër I.M., ka deklaruar se: *“Kur ka dal nga kerri V. ka qenë 10 hapa para tij dhe në atë rast ka dëgjuar disa hapa duke vrapuar pas tij tre persona, dhe pastaj V. ka filluar të vrapojë deri te hyrja e restorantit ku edhe e kanë sulmuar duke e rrëzuar dhe pastaj duke e goditur në pjesën e kokës”*, nga këto deklarata, gjykata ka gjetur se sulmi nuk ka qenë i rastësishëm, e as i provokuar, por të pandehurit e lartcekur e kanë përcjellur të dëmtuarin V.S. dhe kanë pasur qëllim sulmin

ndaj të dëmtuarit V.S., dhe jo që të bisedojnë me të, ndërsa për motivin e sulmit është arsyetuar më lartë.

Faktin që nuk kanë pasur si qëllim vetëm që të bisedojnë me të, dëshmohet edhe nga deklarata e të pandehurit O.H. dhënë në prokurori, i cili ka deklaruar se: *‘‘Kanë planifikuar se si të shkojnë tek televizioni ... që të bisedojnë me V.S. për t’ia tërhequr vërejtjen lidhur me këto postime’’*, në rrethana të tilla, edhe nëse të pandehurit nuk e kanë pasur qëllimi që ta sulmojnë të dëmtuarin, e që gjykata ka vërtetuar se ka ekzistuar ky qëllim si më lartë, nëse të njëjtit nisen vetëm për t’ia tërhequr vërejtjen për disa postime të bërë nga i dëmtuari V.S., në kuadër të drejtave kushtetuese dhe nëse pastaj ndodh edhe sulmi, siç edhe ka ndodhur, atëherë kjo me automatizëm e krijon dashjen direkte si kusht ligjor për kualifikim e kësaj vepre penale, pasi që askush nuk mund t’ia imponoj mendimet të tjerëve apo të kufizojë liritë shprehjes si e drejtë fundamentale të parapara me Kushtetutë dhe akte ndërkombëtare.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale

Gjykata, ka vlerësuar format e kryerjes se veprës penale: *‘‘Lëndimi i lehtë trupor’’* nga neni 185 i KPRK-së, ku në par.1 përcaktohet se: *‘‘Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në: 1.1. dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një organi apo pjese të trupit të personit tjetër; 1.2. zvogëlimin e përkohshëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar; 1.3. shëmtimin e përkohshëm të personit tjetër; ose 1.4. dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

Tutje, Paragrafi 3 përcakton se : *‘‘Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura kryesi dënohet me: 3.1. burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni; ose 3.2. burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij neni’’*,

Gjykata konstaton se në rastin konkret të pandehurit L.D., O.H. dhe K.H., veprën penale e kanë kryer të motivuar nga besimi fetar, të cilën e ka arsyetuar më lartë, andaj gjykata konstaton se janë përmbushur të gjitha elemente e veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par.3.1 lidhur me par. 1 e nenin 31 të KPRK-së.

Nuk qëndron pretendimi i mbrojtës për kualifikimin e kësaj vepre me par.4 ku është përcaktuar se: *‘‘Gjykata mund të shqiptojë vërejtjen gjyqësore ndaj kryesit të veprës nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse kryesi është provokuar nga sjellja ç’njerezore apo e vrazhdë e të dëmtuarit’’*, pasi që gjykata nga administrimi i provave, ka vërtetuar faktin se të pandehurit e lartcekur nuk kanë qenë të provokuar nga sjellja ç’njerezore apo e vrazhdë e të dëmtuarit V.S..

Vendimi i gjykatës lidhur me sanksionin penal

Me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si *rrethanë lehtësuese* gjeti faktin e se të njëjtit janë të moshës relativisht të re dhe faktin se janë penduar për sulmin ndaj të dëmtuarit, ndërsa si *rrethana rënduese* ka gjetur peshën e veprës penale të motivuara nga besimi fetar, këmbëngulësia e të pandehurve për të kryer veprën penale, rrezikshmëria e veprës penale në raport me lirin e shprehjes, sjellën e të pandehurve në gjykatë, nuk e kanë respektuar rregullën dhe rendin në gjykatore, qëndrimin e të pandehurve pran gjykatës ku një zëri kanë deklaruar nuk duam me u gjykua nga gjykata me këto ligje, por vetëm në bazë të ligjeve të Allahut, qëndrimi i tyre se gjatë gjithë procesit gjyqësor nuk kanë pranuar gjykatën si institucion, nuk e kanë pranuar bashkëpunimin dhe komunikimin e as mbrojtjen – avokatët, me këtë rast ata mbi bazën e bindjes se tyre fetare kanë bojkotuar institucionet, si dhe për shkak të natyrës se kësaj veprë penale, gjykata si rrethanë rëndësuese ka marrë për bazë edhe faktin se me këtë vepër penale cenohet një nga të drejtat vitale të njeriut, integriteti trupor dhe në raste të tilla mund të cenohet edhe jeta e njeriut, si një nga të drejtat më absolute të njeriut të njohur me Kushtetutë dhe akte ndërkombëtare, po ashtu, me anë të kësaj veprë është tentuar të cenohet liria e shprehjes si e drejtë fundamentale e çdo njeriut.

Andaj, gjykata duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese si me lartë, peshën e veprës, sjelljen dhe rrethanat e kryesve dhe me qëllim që të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të motivuara nga besimi fetar, e po ashtu duke marrë parasysh edhe të bëjë kompensimin e viktimës për dëmet e shkaktuara nga vepra penale, si dhe për të shprehur gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, ndaj të pandehurve ka shqiptuar dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, i cili dënim sipas vlerësimit të gjykatës është në proporcion me peshën e veprës penale të motivuara nga besimi fetar, me sjelljen e të pandehurve në gjykatë, qëndrimin e tyre në raport me gjykatën, dhe me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë së kryerësve të kësaj veprë penale.

Vendimi i gjykatës mbi shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor neni 452, par.3 të KPP-së ku përcaktohet se: " Në aktgjykimin me të cilin disa të pandehur janë shpallur fajtor, gjykata cakton pjesën e shpenzimeve që duhet paguar secili prej tyre", lidhur me par.1 ku përcaktohet se: " Kur gjykata e shpall të pandehurin fajtor, me aktgjykim vendos se detyrohet t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale".

Vendimi i gjykatës mbi kërkesën pasurore juridike të palës së dëmtuar

Vendimin mbi kërkesën pasurore juridike, gjykata e mori komfor nenit 462, par.2 të KPP-së ku përcaktohet se: " Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore

juridike mund ta realizojë në kontest civil, apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”. ndërsa vendimi për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit është marr sipas Ligjit nr. 05/L-036, për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti Special
PS.nr.36/23, datë 04.01.2024

Bashkëpunëtori Profesional
Albert Haliti

Kryetarja e trupit gjykues– gjyqtarja
Violeta Namani-Hajra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.